

VENDIM
Nr. 8, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
UDHËZIMIT MBI KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E AKSESIT NË HAPËSIRAT E
DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 16, pika 7; 32, pika 1; dhe 63, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike për udhëzimin mbi “Kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e udhëzimit mbi “Kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti